



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opštine/Mayor's Office

Nr.02/607

Data:17.10.2019

Në mbështetje të nenëve 13 dhe 58 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 19 të Rregullores nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive jo financiare në Organizata Buxhetore, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

**FORMIMIN E KOMISIONIT PËR INVENTARIZIMIN E PAURISË JO FINANCIARE
PËR VITIN 2019 NË NJËSIT BUXHETORE**

SHKOLLA FILLORE E MESME E ULËT "HASAN PRISHTINA" GODANC

1. Isak Gashi, Kryesuesi,
2. Ahmet Ahmeti, anëtar,
3. Hasan Mustafa, anëtar.

- I. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit
- II. Komisioni në pajtim me Rregulloren MF-Nr. 02/ 2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatën Buxhetore ka për detyrë dhe përgjegjësi si vijon:
 1. Inventarizimin e të gjithë pasurisë jo financiare që është në pronësi dhe në kontroll të Komunës;
 2. Verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes së pasurisë jo financiare;
 3. Krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare;
 4. Identifikimin e pasurive të dëmtuara dhe jashtë përdorimit;
 5. Përgatitjen e raportit për kryerjen e inventarizimit;
 6. Hartimin e raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare jo me larg se **20.11.2019**
- III. Me kopjen e këtij vendimi njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.
- IV. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit:

Kryetar i Komunës
Naim Ismajli

